



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANI
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.a

**NEON MARTELAC PROFESSIONAL
(BOJË MARTELE PROFESIONALE)
(BOJE DEKORATIVE PER MAKINERI DHE SIPERFAQE METALIKE)**
Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: NEON MARTELAC PROFESSIONAL, është një bojë sintetike me bazë rezinë alkide dhe nitrocelulozë, e cilësisë së lartë dhe me shkëlqim, dhe që thahet shumë shpejt pas aplikimit. Kjo bojë është e destinuar për lyerje të makinerive dhe konstruksioneve të tjera metalike. Referuar përbërësve të saj, në kushte optimale të mjedisit boja thahet 30 min - 5 orë pas aplikimit, duke krijuar një cipë me luspa me shkëlqim të lartë dhe rezistencë të kënaqshme mekanike që u reziston agentëve të jashtëm atmosferik dhe ruan ngjyrën me kalimin e kohës. Ka veti shumë të mira antikorrozive, dhe është shumë e vështirë të shpëputet nga konstruksioni në të cilën është përdorur.

FUSHA E PËRDORIMIT: NEON MARTELAC PROFESSIONAL si një bojë e cilësisë së lartë rekomandohet për makineri dhe çdo lloj konstruksioni tjetër metalik duke ju dhënë jo vetëm shkëlqim por edhe mbrojtje të mëtijshme, si edhe një dekoracion me luspa shumë të veçantë.

NGJYRA: Bojrat MARTELAC të cilat jepen në katalogun e Kompanisë "NEON" ekzistojnë në ngjyrë gri, jeshile, blu, lejla, kafe e hapur dhe kafe e zënë

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet e makinës apo makinerive.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke e holluar fillimisht me diluent NC – 10.00 ose NX – 20. 000 ose White Spirit "NEON" NW – 13.30 në sasi 10 % ÷ 20 %, për të përfutur një bojë të gatshme e cila të punohet vetëm me pistoletë dhe të mos rrjedhë në sipërfaqet vertikale.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe dhe të pa pastruara papaprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....Sipas katalogut
- Imtësia.....20 – 30 μm
- Viskoziteti Dëp Cup 4.....150 – 200 sek
- Densiteti.....1.1 $\pm$ 0.05 g/ml
- Mbulimi7 – 8 m² / L
- Mbetja e thatë.....32 $\pm$ 2%
- Koha e tharjes (për ta prekur) 30 min pas lyerjes
- Koha e tharjes (përfundimtare) 4 – 5 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat MARTELAC janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L.